Informacion për kërkuesit e azilit në Norvegji

Kjo brochure është përpiluar nga Organizata Norvegjeze për Kërkuesit e Azilit (NOAS). NOAS është një organizatë jo-shtetërore e të drejtave të njeriut që u jep informacion dhe ndihmë juridike kërkuesëve të azilit.

Këtu mund të lexoni:

1 Kush ka të drejtë për strehim?
2 Kush mund të marrë leje qëndrimi në bazë humanitare?
3 Cili shtet do të shqyrtojë kërkesën Tuaj për azil?
4 Kush do të shqyrtojë kërkesën Tuaj në Norvegji?
5 Çka ndodh kur kërkoni strehim?
6 Këshilla të rëndësishme për intervistën e azilit
7 Detyrimet dhe të drejtat që keni kur keni kërkuar azil
8 Detyrimi i mbajtjes së sekretit profesional

1. KUSH KA TË DREJTË PËR STREHIM?

Keni të drejtë për strhim, do me thënë për azil, në qoftë se rrezikonheni të vriteni, torturoheni ose ushtrohet ndonjë dhunë serioze ndaj jush nëse ktheheni në vendin Tuaj. Në përgjithësi nuk keni të drejtë të merrni strehim në Norvegji në qoftë se autoritetet e vendit Tuaj mund të Ju mbrojnë, ose në qoftë se ka vende të sigurta për Ju në shtetin Tuaj.

E drejta e strehimit rrjedh nga marrëveshje ndërkombëtare të cilave Norvegjia është e detyruar t'u përmbahet.

2. KUSH KA TË DREJTË PËR LEJE QËNDRIMI NË BAZË HUMANITARE?

Në qoftë se nuk keni të drejtë për strehim, autoritetet do të shikojnë a i plotësoni kushtet për leje qëndrimi në bazë të arsyeve të forta njerëzore ose të lidhjeve të ngushta me Norvegjinë. Kjo quhet leje qëndrimi për shkaqe humanitare. Zakonisht duhet të keni pasaportë për të fituar një leje qëndrimi të këtillë. Mosdorëzimi i pasaportës autoriteteve mund të ketë si pasojë mohimin e kërkesës Suaj ose dhënien e një lejes së kufizuar që nuk shpie as në të drejtën e lejes së qëndrimit të përherëshëm, as në imigracion familjar.

3. CILI SHTET DO TË SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ PËR AZIL?

Jo çdonjëri prej atyre që kërkon strehim në Norvegji do të ketë kërkesën të shqyrtuar në Norvegji. Bashkëpunimi Dublin është një bashkëpunim mes shteteve evropjane dhe do të thotë që kërkesa e një azilkërkuesit shqyrtohet vetëm në një nga shtetet.

Kërkesa e Juaj mund të shqyrtohet në një shtet tjetër të bashkëpunimit të Dublinit në qoftë se Ju në atë shtet:

- jeni regjistruar me shenjën e gishtërinjve
- keni kërkuar azil
- keni vizë ose leje qëndrimi
- keni familje të afërt

Zakonisht autoritetet norvegjeze përdorin dy deri më gjashtë muaj për të vendosur a do të Ju transferojnë në një shtet tjetër.

Nëse dëshironi të keni informacion më të hollësishëm, mund të merrni nga NOAS një broshurë të veçantë mbi bashkëpunimin Dublin.

4. KUSH E SHQYRTON KËRKESËN TUAJ PËR AZIL NË NORVEGJI?

Drejtoria për Huajt (UDI) është një pjesë e pushtetit norvegjez. Atje bëhet intervista me Ju dhe atje mirret vendimi a do të merrni leje qëndrimi apo jo. UDI shqyrton çdo kërkesë saktësisht dhe individualisht.

5. ÇFARË NDODH KUR KËRKONI STREHIM?

Ju regjistrojnë si kërkues azili pranë Policisë
Policia Ju fotografon dhe merr shenjën e gishtërinjve Tuaj. Ju pyesin mbi identitetin Tuaj, mbi rrugën e udhëtimit deri në Norvegji, dhe pse kërkoni strehim. Nëse keni me vete letra që tregojnë identitetin Tuaj, duhet t'i dorërzoni gjatë regjistrimit.

Shpërnguleni në një vendpranim
Pas regjistrimit ju çojnë në një vendpranim të përkohshëm ku do të rrini disa ditë dhe pastaj shpërnguleni në një vendpranim tjetër të transitit ose në një vendpranim të zakonshëm. Të punësuarit e vendpranimit do të Ju japin informacione më të gjëra mbi detyrimet dhe të drejtat Tuaja.

Do të bëni kontrollin për tuberkuloz
Gjatë ditëve të para në vendpranimin e përkohshëm do të bëni kontrollin për tuberkuloz. Kontrolli është i detyrueshëm për të gjithë. Nëse keni një problem serioz shëndetërsor me nevojë akute për trajtim duhet ta lajmëroni zyrën shëndetësore.

Merrni informacion dhe udhëzim nga NOAS
Gjatë diteve të para në vendpranimin e përkohshëm do të merrni informacion nga NOAS. NOAS është një organizatë jo-shtetërore e të drejtave të njeriut që punon për të drejtat e azilkërkuesëve në Norvegji. Roli i NOAS-it në vendpranimet është dhërja e informacionit dhe e udhëzimeve kërkuesëve të azilit. Do të shihni një film informativ mbi procedurën e azilit dhe do të folni me një person të punësuar në NOAS. Qëllimi i bisedës është që të Ju përgatisin për intervistën në UDI. Ka rëndësi të madhe që ta përdorni bisedën për të pyetur çdo gjë që duhet të dini në lidhje me kërkesën për strehim. Biseda do të bëhet në një gjuhë që Ju kuptoni mire.
Në qoftë se ka gjasa që do të Ju transferojnë në një shtet tjetër evropjan sipas rregullores së Dublinit, duhet ta tregoni këtë, në mënyrë që të merrni informacionin e përshtatshëm.
Të punësuarit në NOAS kanë detyrimin e ruajtjes së sekretit.

UDI do të bëjë intervistën me Ju
Intervista për azil është mundësia më e rëndësishme për të sqaruar pse kërkoni strehim. Zakonisht, intervista zgjat disa orë. Tregoni konkretisht dhe hollësisht se çfarë keni përjetuar dhe se ç'druani që mund të ndodhë nëse duhet të ktheheni në vendin Tuaj. Gjatë intervistës do të ketë një përkthyes/e. Përkthyesi/ja ka detyrën e mbajtjes së sekretit dhe është neutral/e. Nëse keni vështirësi që të kuptoni se çfarë flitet, duhet ta lajmëroni menjëherë atë që bën intervistën.

Në fund të intervistës nënshkruani një raport mbi atë që është thënë gjatë intervistës. Përkthyesi/ja do Tua lexojë. Nëse doni të ndërroni diçka në intervistën, duhet ta bëni atë para se të nënshkruani.

Shpërnguleni në një vendpranim të rregullt ku do të banoni ndërsa pritni përgjigje ngaUDI
Vendpranimi është një ofertë falas. Gjatë kohës së pritjes së përgjigjes nga UDI mund të banoni edhe privatisht, por atëherë nuk merrni mbështetje ekonomike. Në rast se shpërnguleni duhet të lajmëroni adresën Tuaj në vendpranimin për të regjistruar adresën. Regjistrimi i adresës është i rëndësishëm për të siguruar që përgjigja nga UDI mund të bijë në dorë.

Informacion i ri

Në qoftë se merrni informacione të rëndësishme për kërkesën Tuaj pas intervistës për azil, duhet ta lajmëroni UDI-n menjëherë. Tregoni se pse nuk keni treguar ato gjëra më herët. Të punësuarit e vendpranimit do të tregojnë se si duhet ta bëni këtë.

Pritni përpëgjigje nga UDI
UDI mund të përdorë disa javë e deri më tepër se një vjet për të shqyrtuar kërkersën Tuaj. Shkaku se pse shkon aq kohë e gjatë është se UDI duhet të kontrollojë a janë të përpikta informacionet që keni dhënë. Shkaku mund të jetë edhe që UDI kontrollon gjendjen në vendin Tuaj, ose që ka shumë persona tjera që presin përgjigje nga UDI.

Merrni përgjigje nga UDI: Leje qëndrimi ose refuzim

Leje qëndrimi
Në qoftë se merrni leje qëndrimi do të Ju ofrojnë të vendoseni në një komunë.Vendpranimi do të japë informacion më të gjërë.

Refuzim
Në qoftë se merrni përgjigje negative në kërkesën, keni të drejtë të ankoheni. Merrni një avokat falas, zakonisht për pesë orë, që Ju ndihmon me ankesën. Duhet të ankoheni brenda një afati prej tri javësh. Zakonisht mund të rrini në Norvegji gjatë kohës së shqyrtimit të ankesës, por jo në rast se UDI konsideron që kërkesa është qartësisht pa bazë.

Gjykata e Ankesave për të Huajt (UNE)
UNE është enti që shqyrton ankesën Tuaj. UNE mund të Ju thërrasë për një takim ose mund të kërkojë që të dërgoni informacione më të plota.

Kur merrni refuzim, jeni i detyruar të ktheheni në vendin Tuaj
Duhet të shkoni në vendin Tuaj brenda afatit të caktuar nga policia, zakonisht brenda dy javëve. Pas këti afatit nuk keni as qëndrim legal në Norvegji, as të drejtë të banoni në një vendpranim.

Në qoftë se merrni refuzim definitiv, d.m. th, që vendimi i UNE-s i përputhet vendimit të UDI-s, keni mundësi të largoheni vullnetarisht me ndihmën e International Organization for Migration (IOM) apo të Ju transportojë policia (kthim i detyrueshëm).

Kthim vullnetar me IOM
Autoritetet norvegjeze e rregullojnë kthimin vullnetar në vendin Tuaj. Kthim vullnetar do të thotë që bashkëpunoni Ju vet në lidhje me kthimin Tuaj duke

kërkuar programin vullnetar për kthim nga Norvegjia, i quajtur Voluntary Assisted Return (VARP).

Programi VARP është program për bashkëpunim në mes të UDI-s dhe IOM-s për organizimin e kthimit Tuaj. Kur ktheheni vullnetarisht, shteti norvegjez e pagon udhëtimin.

Personat që nuk kanë leje qëndrimi në Norvegji mund të kërkojnë kthim vullnetarisht. Nëse kërkesa Juaj për azil refuzohet, keni një kohë të kufizuar për lëshimin e Norvegjisë. Kur dëshironi të ktheheni vullnetarisht duhet brenda një kohë të shkurtë pas refuzimit të dërgoni një kërkesë në IOM. Kur kërkesa Juaj miratohet, IOM do të Ju drejtojë dhe do të Ju ndihmojë në marrjen e dokumenteve të udhëtimit dhe në porositjen e biletave. Për të udhëtuar me IOM duhet të keni një pasaportë të vlefshëm ose dokument tjetër udhëtimi nga autoritetet e vendit Tuaj. Nëse nuk keni pasaportë ose dokument udhëtimi IOM do të Ju ndihmojë me kërkesë në ambasadën/konsulaten më të afërt. Nëse Ju vet dëshironi, IOM do të Ju ndihmojë, si gjatë udhëtimit, ashtu edhe në arritjen në vendin Tuaj.

Informacion dhe ndihmë në plotësimin e formularit të kërkesës mund të merrni nga vendpranimi ku gjindeni, nga zyrat regjonale të UDI-s ose nga IOM.

Kthim i detyrueshëm
Në qoftë se pas refuzimit përfundimtar nuk largoheni vullnetarisht për në vendin Tuaj, policia do të Ju transportojë jashtë shtetit pas skadimit të afitit për largim.

Attëherë Ju duhet të pagoni Ju vet shpenzimet e transportimit. Në qoftë se nuk keni mjete për të paguar biletën e aeroplanit, shteti do të mbulojë shpenzimet, por do të jeni i detyruar të ktheni shumën. Në qoftë se nuk e paguani çmimin e transportimit, mund të Ju mohohet më vonë marrja e vizës dhe e hyrjes në Norvegji dhe në shumicën e shteteve evropiane.

Kur kryeni vepra penale
Nëse kryeni vepra kriminale, kërkesa e Juaj për azil shqyrtohet shumë shpejt, ashtu që të mundësohet largimi i Juaj nga Norvegjia sa më shpejt. Edhe kur bëni diçka të paligjshme mund të Ju dëbojnë nga Norvegjia. Dhe kjo shpie në ndalimin e hyrjes më vonë në Norvegji dhe në shumicën e shteteve tjera të Evropës.

6. KËSHILLA TË DOBISHME PËR INTERVISTËN E AZILIT

- Tregoni thellësisht dhe hollësisht se pse Ju është dashur të lëshoni vendin Tuaj dhe çfarë druani mund të Ju ndodh në rast kthimi.
- Përqëndroni në gjërat që keni përjetuar Ju vet dhe në atë që mund të ndodh në rast kthimi.
- Të jeni sa më i përpiktë që është e mundur.
- Në qoftë se keni me vete fëmijë nën moshën 18 vjeçare, kallxoni situatën dhe përjetimet tyre.
- Nëse ka diçka që nuk kuptoni, luteni personin që bën intervistën që ta sqarojë.
- Nëse keni dokumente të rëndësishme për kërkesën e azilit, duhet t'i merrni me vete në intervistën.
- Tregoni të vërtetën. Në qoftë se thoni diçka që nuk është e vërtetë mund të Ju refuzojnë kërkesën për azil. Gjithashtu, mund të Ju dëbojnë nga Norvegjia, dhe kjo mund të ketë si pasojë që në të ardhmen nuk mund të hyni në Norvegji dhe as në shumicën e shteteve të Evropës.

Kërkueset femra
Femrat mund të jenë të përndjekura në mënyra tjera se meshkujt. Mund të jetë e vështirë tregimi i këtyre rasteve, ndoshta sidomos një mashkullit. Në qoftë se dëshironi, mund të folni me një femër të punësuar në NOAS. Lajmëroni NOAS-in sa më shpejt pasi ta keni parë filmin informativ.
Mund të kërkoni edhe që intervista në UDI të bëhet nga një femër, me një përkthyese. Këtë dëshirë mund ta shprehni gjatë bisedës me NOAS.

Keni ardhur bashkë me fëmijë nën moshën 18 vjeç?
Situata e fëmijës është e rëndësishme në shqyrtimin e kërkesës për azil. UDI dëshiron të dijë a ka fëmija një bazë të vet për azil, dhe si e përjeton fëmija situatën e vet jetësore. Është e rëndësishme që këtë të ja tregoni UDI-s.

UDI bisedon me fëmijë mbi 7 vjeç. Është e rëndësishme që fëmija të tregojë vet se ç'ka përjetuar. Disa herë fëmijtë përjetojnë problemet më fort se të rriturit. UDI nuk bën kurrë biseda me fëmijë që nuk duan të flasin vet.

7. DETYRIME DHE TË DREJTA SI KËRKUES I AZILIT

Jeni i detyruar të bashkëpunoni për sqarimin e identitetit Tuaj
Është e rëndësishme për autoritetet norvegjeze që të dijnë se kush jeni. Për këtë ka rëndësi që të dorëzoni dokumentet që vërtetojnë se kush jeni. Në qoftë se jeni i përndjekur nga autoritetet e vendit Tuaj, autoritetet norvegjeze nuk do të kërkojnë që të viheni në kontakt me ata për marrjen e dokumenteve të identitetit.

Në qoftë se autoritetet norvegjeze janë të dyshimtë mbi identitetin Tuaj, rrezikoni që:

- Të mos Ju besojnë
- Zvogëlohet mundësia e marrjes së qëndrimit
- T'i humbni të drejtat që do të kishit përndryshe
- Të merrni leje qëndrimi të përkohshme

Jeni i detyruar të jepni informacione të sakta
Si kërkues azili duhet të sqaroni se pse kërkoni strehim. Prandaj duhet të bëni ç'mos për të bashkëpunuar dhe për të paraqitur dokumentimin e nevojshëm. Pa marrë parasysh se ç'keni dëgjuar nga tjerë para se të keni kërkuar strehim, është e rëndësishme që t'i tregoni autoriteteve norvegjeze shkakun e vërtetë për kërkesën e azilit. Dhënia e informacioneve të pasakta ndëshkohet. Mund të ketë si pasojë edhe dëbimin.

Keni të drejtë të punoni gjatë kohës kur jeni kërkues i azilit
Kur mund të vërtetoni identitetin Tuaj dhe nuk jeni nën procedurën e Dublinit mund të merrni leje që të punoni gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës për azil. Leja vlen për gjashtë muaj, por mund të përtëritet.

Keni të drejtë për trajtim mjekësor
Keni të drejtë të merrni trajtim mjekësor të nevojshëm gjatë kohës së pritjes në përgjigje për kërkesën e azilit. Që fëmijë nën 12 vjeç trajtimi është falas. Zakonisht të gjithë duhet të paguani një pjesë vetjake te mjeku. Në qoftë se keni nevojë për ndihmë nga një psikolog mund të kërkoni që UDI të mbulojë shpenzimet Tuaja. Kontaktoni të punësuarit në vendpranimin për informacion më të gjërë. Duhet të njoftoni UDI-n në qoftë se keni probleme të rënda shëndetësore.

Mund ta tërheqni kërkesën për azil
Mund ta tërheqni në çdo çast kërkesën për azil. Atëherë mund të kërkoni IOM-n për ndihmë me kthimin në vendin Tuaj.

8. DETYRIMI I MBAJTJES SË SEKRETIT PROFESONAL

Policia, UDI, UNE, përkthyesi, avokati, personeli shëndetësor dhe NOAS kanë detyrimin e mbajtjes së sekretit profesional. Kjo do të thotë që nuk mund të japin informacion mbi kërkesën Tuaj për azil autoriteteve të vendit Tuaj. Gjithashtu, nuk mund t'i tregojnë se ç'keni treguar Ju përsonave që nuk punojnë me kërkesën Tuaj për azil. Thyerja e detyrimit të ruajtjes së sekretit profesional ndëshkohet. Kjo do të thotë se nuk duhet të keni frikë të sqaroni thellësisht se pse keni nevojë për strehim.

ADRESA

Njësia e Policisë për të Huajt
Policia regjistron azilkërkuesit të posaardhur.
Poashtu, policia largon kërkuesit e azilit që nuk e lëshojnë Norvegjinë vullnetarisht pas refuzimit.

Adresa postale: Postboks 8102 Dep., 0032 OSLO
Adresa për vizitë: Christian Kroghs gate 32, Oslo
Telefon: 22 34 24 00, telefaks: 22 34 24 80
Postë elektronike: pu@politiet.no

Drejtoria për të Huajt (UDI) është një institucion shtetëror që, ndër tjerë, shqyrton kërkesat për azil, për bashkim familiar, për vizë dhe për shtetësi. UDI është përgjegjës edhe për vendpranimet për azilkërkuesit.

Adresa postale: Postboks 8108 Dep., 0032 Oslo
Adresa për vizitë: Hausmannsgate 21, Oslo
Telefon: 23 35 16 00, telefaks: 23 35 15 01
Internet: www.udi.no, postë elektronike: ots@udi.no

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM)
Informacion për kthim vullnetar

Adresa postale: Postboks 8927 Youngstorget, 0028 Oslo
Adresa për vizitë: Storgata 10a, kati 2., Oslo
Orari:
Ditët e javës: 10:00 – 15:00
Ditët e festës: Mbyllur
Telefon: 23 10 53 20
Telefaks: 23 10 53 23
Postë elektronike: osloreturn@iom.int

Gjykata e Ankesave për të Huajt (UNE) është një organ administrativ që i ngjan gjykatës për shqyrtimin e ankesave në lidhje me refuzim nga UDI.

Adresë postale: Postboks 8165 Dep., 0034 Oslo
Adresa për vizitë: Stenersgate 1 B/C, Oslo
Telefon: 21 08 50 00, telefaks: 21 08 50 01
Internet: www.une.no, postë elektronike: postmottak@une.no

Kryqi i Kuq Norvegjez, shërbimi i gjetjes, ndihmon në rikrijimin e kontaktit në mes të anëtarëve të families që janë humbur në lidhje me luftë, konflikte ose katastrofa.
Kryqi i Kuq nuk jep informacione mbi Ju as UDI-s, as tjerëve. Shërbimi është falas.

Adresë postale: Postboks 1 – Grønland, 0133 Oslo
Adresë për vizitë: Hausmannsgt. 7, Oslo
Telefon: 22 05 40 00
tracing@redcross.no